

Informacion per subjektin “Partia Uniteti Kombëtar”

Për kryerjen e auditimitin e fondeve te përfituara dhe shpenzuara nga Partia Uniteti Kombëtar për vitin kalendarik 2020

Drejtuar: Komisionit Qendror të Zgjedhjeve Subjektit “Partia e Unitetit Kombetar” Tiranë

Me cilesine e Audituesit Ligjor (Ekspertit Kontabël te Regjistruar), të caktuar Vendimit Nr. 425 date 12/07/2021 te Komisionit Qendror te Zgjedhjeve “ Per shpalljen e rezultatit te shortit per emerimin e eksperteve kontabel te licensuar, te cilet do te kryejne auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga partite politike per vitin kalendarik 2020”për realizimin e auditimit kemi kryer procedurën e mëposhtme:

Mbas nënshkrimit të Kontratës Kontrates se sherbimit me nr. 6274 date 23/08/2021 e lidhur me Komisionin Qendror te Zgjedhjeve per auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga “Partia e Unitetit Kombetar”, derguam njoftim nepermjet Postes Shqiptare ne adresen e marre nga Regjistri per Partite Politike, të cilin e bëmë me dije me :

- Vendimin Nr. 425 date 12/07/2021 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për të bërë të mundur realizimin e auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2020.
- Kontratën nr. 6274 date 23/08/2021 lidhur me KQZ për auditimin e fondeve të përfituara dhe shpenzuara nga Partitë politike për vitin kalendarik 2020

Drejtuesit e Subjektit “Partia e Unitetit Kombetar” na kanë konfirmuar zyrtarisht se kane zero fonde te perfituara për vitin 2020, dhe zero fonde te shpenzuara për këtë vit. (pergjigja bashkangjitur)

Si konkluzion për shkak se procedurat e mësipërme nuk përbëjnë auditim dhe as rishikim të bërë në përputhje me Standartet Ndërkombëtare të auditimit ne nuk mund të shprehim asnjë opinion për fondet e përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit 2020 nga “**Partia e Unitetit Kombetar**”.

Auditues ligjor



Tiranë me 23/09/2021

BLV, Gjergj Fishta, Nr. 11, Hyrja II, Kati II, mbi Credins Bank, Tiranë,
Nr. Kontakti Cel.0692087743 , e-mail pulaj_anita@yahoo.com



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PARTIA E UNITETIT KOMBËTAR (PUK)
SELIA QËNDRORE

Adresa: Kutia Postare 8288, Tiranë,
Tel. 068 20 02 951 & 069 27 50 898
E-mail ldajetbegiri@hotmail.com

Nr.28/08 Akti

Tiranë, më 29.08.2021

Lënda: Përgjigje tuajës datë 25.08.2021 për auditimin financiar në Partinë e Unitetit Kombëtar për vitin 2020.

ZNJ. ANITA PULAJ
Bulevardi "Gjergj Fishta", Pall. "G8P", Hyrja 2, Kati 2
TIRANË

Për njoftim: KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE
TIRANË

E nderuara Znj. Anita,

Ju bëjmë me dije se KQZ për çdo vit ka caktuar një auditues, ekspert kontabël, i cili ka mbajtur kontakte me Partia e Unitetit Kombëtar.

Për çdo vit nga ana jonë është deklaruar faktin se Partia e Unitetit Kombëtar, prej vitit 2001, vit në të cilin nuk mundi të merrte më deputet për t'u përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë, dhe deri në vitin 2021, në të cilin ndodhemi, nuk ka marrë asnjë fond nga buxheti i shtetit, edhe kur i janë planifikuar për t'u tërhequr nga KQZ, sipas përqindjeve fituese në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë apo për pushtetin vendor.

Pra për 20 vjet me radhë, megjithëse n'a janë akorduar fonde nga buxheti i shtetit, nuk i kemi tërhequr ato si dhe nuk kemi patur dhe nuk kemi asnjë burim financimi, nga kushdoqoftë, që të pasqyronim në raportet vjetore, duke shënuar për çdo vit faktin real "zero hyrje dhe zero shpenzime".

Ekspertët kontabël të caktuar nga ana e KQZ për të bërë auditimin dhe për të paraqitur raportin financiar të çdo viti, megjithëse nga ana jonë është bërë raportimi për "Zero" shpenzime si dhe për "Zero"

tërheqje fondi të akorduar për PUK nga buxheti i shtetit, gjatë këtyre 20 vjetëve, kërkonin një shpërblim prej 100.000 apo 50.000 lekë të reja nga ana jonë!

I kemi bërë me dije KQZ se e kemi objektivist të pamundur të paguajmë ekspertët e tyre, pasi nuk kemi asnjë llogari, nuk kemi tërhequr asnjë fond nga buxheti i shtetit dhe nuk kemi bërë asnjë shpenzim gjatë fushatave elektorale, megjithëse gjatë këtyre 20 vjetëve kemi patur një përfaqësim modest me këshilltarë bashkiak në të gjithë vendin.

Në kushtet e mësipërme, kur nuk kemi patur dhe nuk kemi asnjë marrëdhënie me buxhetin e shtetit, kur për 20 vjet me radhë nuk kemi pranuar të tërheqim asnjë fond të akorduar, duke e djegur ato dhe duke kaluar në favor të shtetit, në kushtet kur nuk kemi asnjë burim qoftë edhe të vetëm financiar nga të tretët, asnjë ndihmë etj, kur nuk kemi bërë asnjë shpenzim për fushatat elektorale, të paguajmë një eksperte kontabël të KQZ, e kemi konsideruar jo të drejtë.

Pra përfundimisht, në pasqyrat financiare për vitin 2020 kemi për të pasqyruar "Zero" fonde të përfituara, "Zero" fonde të Shpenzuara nga Partia e Unitetit Kombëtar.

**KRYETARI I PUK
AV. IDAJET BEQIRI**

